



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Numri: KSC-BC-2020-04
Vendos: Gjykatësi i procedurës paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon
Pjesëmarrës parashtrues: Prokurori i Specializuar
Data: 26 prill 2021
Gjuha: Anglishte
Klasifikimi: Publik

Version i redaktuar publik i

'Parashtrimi të Aktakuzës për konfirmim dhe kërkesa lidhur me të' parashtrimi

KSC-BC-2020-04/F00002 i datës 14 shkurt 2020

me shtojcën publike 1

Zyra e Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit

Z. Zhan-Lui Zhilisen

A. HYRJE

1. Në bazë të nenit 38(4) të Ligjit¹ dhe rregullës 86(2)-(3) të Rregullores,² Zyra e Prokurorit të Specializuar ('ZPS') parashtron për konfirmim një aktakuzë kundër Pjetër SHALËS, gjithashtu i njohur si 'Ujku', në lidhje me krime të kryera në Kukës, Shqipëri, në vitin 1999 ('Aktakuza').³ Aktakuza dorëzohet së bashku me material mbështetës⁴ dhe një përmbledhje të detajuar ku tregohet lidhja e çdo prove me secilën akuzë.⁵
2. Z. SHALA u lind më 17 shtator 1963 në Prizren, Kosovë. Aktakuza dhe materiali mbështetës demonstron se ekziston dyshim i bazuar mirë⁶ se z. SHALA ka kryer ose ka marrë pjesë në kryerjen e krimeve të luftës brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara. Rrjedhimisht, ZPS-ja i kërkon gjykatësit të procedurës paraprake që ta konfirmojë Aktakuzën.
3. Në bazë të nenit 3(8)(a), për arsye të sigurisë dhe për administrimin e duhur të drejtësisë, ZPS-ja kërkon caktimin e vendit të zhvillimit të procesit në shtetin pritës në lidhje me këtë fazë dhe të gjitha fazat vijuese të procedimit që burojnë nga ose janë në lidhje me Aktakuzën.
4. Gjithashtu, pas konfirmimit të Aktakuzës, ZPS-ja i kërkon gjykatësit të procedurës paraprake (i) të lëshojë fletarrestim dhe urdhër për transferimin e z. SHALA, në përputhje me nenet 39 dhe 41 dhe rregullat 30-33, 37, 39, 48, 50, 53, 55, dhe 86(6)(b); (ii) në përputhje me nenet 23, 35(2), dhe 39 dhe rregullat 30, 80, dhe 88(2), të

¹ Ligji nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015 ('Ligji'). Përveçse kur specifikohet ndryshe, të gjitha referencat për 'neni/nenet' i referohen Ligjit.

² Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev1/2017, 5 korrik 2017 ('Rregullorja'). Përveçse kur specifikohet ndryshe, të gjitha referencat për 'rregulla/rregullat' i referohen Rregullores.

³ *Shih* Shtojca 1. Në përputhje me rregullën 86(1), Prokurori i Specializuar e ka informuar Kryetaren, e cila cakton një gjykatës të procedurës paraprake në pajtim me nenin 33(1)(a).

⁴ Materialet mbështetëse janë dorëzuar si pako më vete nëpërmjet sistemit elektronik *Legal Workflow*.

⁵ *Shih* Shtojca 2. *Shih gjithashtu* rregulla 86(3)(b).

⁶ Neni 38(4) dhe rregulla 86(1). *Shih gjithashtu* Kosovë, Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale, 2012 ('KPP'), neni 19(1.12) ('Dyshim i bazuar mirë – nënkupton ngritjen e aktakuzës. Posedimi i provave të pranueshme që do të bindte një vëzhgues objektiv që një veprë penale ka ndodhur dhe që është kryer nga i pandehuri').

urdhërojë mosnxjerrjen publike të Aktakuzës dhe dokumenteve e informacionit në lidhje me të deri në një urdhër të mëtejshëm; dhe (iii) në përputhje me nenet 23, 35(2), dhe 39 dhe rregullat 30, 80, dhe 105, të urdhërojë mosnxjerrjen e përkohshme të identitetit të dëshmitarëve dhe viktimave që përmenden në materialin mbështetës deri sa të urdhërohen masat e duhura mbrojtëse.

B. KËRKESË PËR LËSHIMIN E FLETARRESTIMIT DHE URDHËRIT TË TRANSFERIMIT

5. Kriteret e përcaktuara në nenin 41(6) për arrestimin dhe paraburgimin e z.

SHALA janë përmbushur:

- i. Materialet mbështetëse provojnë se ekziston dyshim i bazuar⁷ se z. SHALA ka kryer vepra penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, sikurse paraqiten në Aktakuzë dhe sikurse kërkohet në bazë të nenit 41(6)(a); dhe
- ii. Të tri arsyet alternative të përcaktuara në nenin 41(6)(b) janë përmbushur në këtë rast. Ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se (1) ekziston rrezik i arratisjes; (2) z. SHALA do të pengojë ecurinë e procedimit penal, ndër të tjera përmes ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryesit; dhe (3) pesha e veprës penale, ose mënyra apo rrethanat e kryerjes së veprës penale, dhe karakteristikat personale të z. SHALA, veprimet dhe sjellja e tij në të kaluarën, rrethi dhe kushtet në të cilat ai jeton, ose rrethana të tjera personale, vënë në dukje rrezikun e përsëritjes së veprës penale ose të kryerjes së një vepre penale që ka kërcënuar se do ta kryejë. Për përcaktimin e këtyre rreziqeve 'nevojitet të vlerësohet

⁷ Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për fletarrestim, KSC-BC-2018-01/F00032, 12 prill 2019, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* ('Vendim mbi fletarrestimin'), para.18 (i referohet përkufizimit të 'dyshimit të bazuar' në KPP, përkatësisht si 'njohuri për informacionin që do të bindte një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur, po ndodh ose ka mundësi të konsiderueshme që do të ndodhë dhe se personi në fjalë ka më shumë gjasa që të ketë kryer veprën penale se sa që të mos e ketë kryer atë').

mundësia e këtyre rreziqeve përkundrejt pashmangshmërisë së materializimit të tyre'.⁸

1.Z. SHALA mund të arratiset⁹

6. Kur t'i bëhen të ditura veprat penale për të cilat akuzohet dhe dënimet e parapara për ato vepra penale, z. SHALA do të ketë motivin për t'iu shmangur gjykitimit dhe rrezikut të një vendimi për fajësi penale. Motivi i tij për t'u arratisur mund të ndikohet më tej nga dijenia për vendimet e raportuara publikisht për fajësi penale të bashkëkryesve Sabit GECI and Xhemshit KRASNIQI për vepra penale të kryera kundër të ndaluarve që u mbajtën në Kukës prej disa anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ('UÇK').¹⁰

7. Z. SHALA gjithashtu ka mjetet dhe mundësinë për t'iu shmangur drejtësisë. Z. SHALA është banor dhe shtetas i Mbretërisë së Belgjikës. Si i tillë, ai jeton në një juridiksion ku Dhomat e Specializuara nuk kanë mjet të drejtpërdrejtë për të detyruar paraqitjen e tij në gjyq. Ai ka të drejtën e lëvizjes së lirë brenda Bashkimit Evropian dhe disa shteteve fqinje. Për më tepër, brenda zonës së Shengenit, ai nuk do të përballej me kontrole kufitare sistematike. Z. SHALA flet rrjedhshëm frëngjishten dhe shqipen dhe do të mundej shumë lehtë të vendosej në komunitete ku flitet frëngjishtja ose shqipja në qoftë se do të largohet nga Belgjika. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].¹¹

2.Z. SHALA mund të pengojë ecurinë e procedimit penal¹²

8. Veprimet dhe sjellja e mëparshme e z. SHALA, ndër të tjera sikurse përshkruhet më poshtë, demonstrojnë rrezikun se ai mund të ndërhyjë ndaj

⁸ Vendim mbi fletarrestimin, KSC-BC-2018-01/F00032, para.19.

⁹ Neni 41(6)(b)(i).

¹⁰ *Shih* Kosovë, Gjykata Themelore në Mitrovicë, *Lënda Penale kundër X. KRASNIQIT*, P.Nr.184/15, Aktgjykim, 8 gusht 2016; Kosovë, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, *Lënda penale kundër S. GECIT*, P.Nr.45/10, Aktgjykim, 29 korrik 2011.

¹¹ [REDAKTUAR].

¹² Neni 41(6)(b)(ii).

dëshmitarëve, viktimave, ose bashkëkryesve, dhe ndryshe të orvatet të pengojë procesin. Ai ka motivin, mjetet dhe mundësinë për ta bërë këtë.¹³

9. Për shembull, kur të informohet për pretendimet e përfshira në Aktakuzë, z. SHALA mund të deduktojë saktësisht se ndër dëshmitë kundër tij lidhur me ngjarjet në Kukës [REDAKTUAR].¹⁴ [REDAKTUAR]¹⁵ [REDAKTUAR].¹⁶ [REDAKTUAR].¹⁷

10. Gjithashtu, kur të informohet për pretendimet e përfshira në Aktakuzë, z. SHALA [REDAKTUAR]¹⁸ [REDAKTUAR].¹⁹ [REDAKTUAR], çka demonstroi se ekziston rreziku që z. SHALA të orvatet të ndërhyjë ndaj [REDAKTUAR] dëshmitarëve [REDAKTUAR] të mundshëm dhe përndryshe të pengojë procesin.

3. Ekzistojnë arsye për të besuar se z. SHALA mund të kryejë vepra penale

11. Krahas natyrës kriminale të vetvetishme të çdo përpjekjeje për ndërhyrje ndaj administrimit të drejtësisë, në bazë të deklaratave që ka bërë z. SHALA dhe duke u nisur nga veprimet dhe sjellja e tij në të kaluarën, ekziston rrezik real se ai mund të kryejë vepra penale të tjera, ndër të tjera përmes veprimeve dhe sjelljeve të ngjashme me ato që përshkruhen në Aktakuzë, për t'iu shmangur ballafaqimit me përgjegjësinë për veprat penale për të cilat akuzohet, duke përfshirë përmes përdorimit të dhunës fizike dhe kërcënimeve për përdorimin e dhunës, ose përpjekjeve për të angazhuar ose nxitur të tjerë që të kryejnë akte të dhunës kundër [REDAKTUAR] dëshmitarëve

¹³ *Shih* para. 6-7 më lart.

¹⁴ [REDAKTUAR].

¹⁵ [REDAKTUAR].

¹⁶ [REDAKTUAR].

¹⁷ [REDAKTUAR].

¹⁸ [REDAKTUAR].

¹⁹ [REDAKTUAR].

[REDAKTUAR] të mundshëm ose t'i kërcënojnë se do të përdorin dhunën kundër tyre.

4. Autorizimi i kontrollimit dhe sekuestrimit

12. Në bazë të neneve 35(2), 39(3) dhe 55, dhe rregullave 30-33, 37 dhe 39,²⁰ ZPS-ja kërkon që në kuadër të fletarrestimit, gjykatësi i procedurës paraprake të autorizojë autoritetet zbatuese të fletarrestimit ²¹ që në praninë e një përfaqësuesi të ZPS-së:²² (i) të kontrollojnë z. Shala, vendarrestimin dhe vendbanimin e tij; dhe (ii) të sekuestrojnë çfarëdo prove që besohet se është përdorur në kryerjen e, është në lidhje me, ose mund të jetë provë e rëndësishme për veprat penale që janë objekt i akuzave, në veçanti çfarëdo prove që lidhet me veprimtarinë e z. Shala midis 1998 dhe 1999, marrëdhëniet ose kontaktet e tij me viktimat ose bashkëkryesit e pretenduar, dhe/ose Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK") dhe/ose qeverinë e përkohshme të Kosovës ("QPK"), apo anëtarë të tyre. Ndër sende të tilla mund të përfshihen: të dhëna për kontakte apo mbledhje, ditarë, regjistra, vendime, fotografi, videoincizime, audioincizime, urdhra, udhëzime, direktiva, raporte, politika, protokolle ose rregullore, si dhe kompjuterë, telefona dhe pajisje të tjera që logjikisht mund të pritet se përmbajnë prova relevante.

13. Ekziston dyshim i bazuar se z. SHALA si ish-anëtar i UÇK-së ka kryer vepra penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara,²³ dhe rrjedhimisht dyshim i bazuar se ai mund të ketë prova relevante me vete, në vendarrestimin ose në vendbanimin e tij.²⁴ Më tej, duke marrë parasysh rrezikun e ndërhyrjes dhe pengimit, ndër të tjera sikurse përshkruhet më lart,²⁵ provat që mund të ketë z. Shala nuk mund

²⁰ *Shih gjithashtu* Vendim për autorizimin e sekuestrimit të një sendi, KSC-BC-2018-01/F00017, 11 mars 2019, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para.13.

²¹ Z. SHALA jeton në Belgjikë. Belgjika ka pranuar të bashkëpunojë me Dhomat e Specializuara dhe ZPS-në. *Shih* Belgjikë, *Loi concernant la cooperation avec la Cour pénale internationale et les tribunaux pénaux internationaux*, 29 mars 2004 (ndryshuar për herë të fundit më 11 korrik 2018) ('Ligji i Belgjikës për Bashkëpunim'), veçanërisht nenin 84(3) (në lidhje me kontrollimet dhe sekuestrimet e kërkuara nga Dhomat e Specializuara).

²² Ligji i Belgjikës për Bashkëpunim, neni 85 (që autorizon prokurorin të ndihmojë në zbatimin e masave të kërkuara).

²³ *Shih gjithashtu* para.5 më lart.

²⁴ Rregulla 37(2)(a), (3).

²⁵ *Shih* para. 6-11 më lart.

të sigurohen në mënyrë tjetër dhe kontrollimi e sekuestrimi në kuadër të arrestimit të tij mund të jenë e vetmja masë e efektshme për nevojat e hetimit.²⁶

14. Cenimi i shkaktuar mbi të drejtën për privatësi dhe pronë të z. SHALA është proporcional me qëllimin legjitim të hetimit dhe masa hetimore nuk eliminon thelbin e këtyre të drejtave.²⁷ ZPS-ja do t'u përcjellë informacionin dhe udhëzimet e nevojshme autoriteteve që do të kryejnë kontrollimin dhe sekuestrimin, në një mënyrë që përjashton informacion që nuk parashikohet të jetë i rëndësishëm dhe në përputhje me garancitë mbrojtëse të parapara në rregullën 39.

15. ZPS-ja kërkon autorizimin e mbajtjes në ruajtje të çfarëdo prove të sekuestruar (i) për aq kohë sa është e nevojshme për vlerësimin e provave; dhe (ii) në qoftë se provat gjykohen relevante, autorizimi të zgjatet për aq kohë sa është e nevojshme për hetimet dhe procesin gjyqësor.

5. Urdhri i transferimit dhe zbatimi

16. Duke mbajtur parasysh kërkesën e ZPS-së për caktimin e vendit të zhvillimit të procesit në shtetin pritës,²⁸ ZPS-ja i kërkon gjykatësit të procedurës paraprake të urdhërojë transferimin e z. SHALA nga Belgjika²⁹ në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në shtetin pritës, në përputhje me rregullën 50(2).

17. ZPS-ja i kërkon gjykatësit të procedurës paraprake që fletarrestimin së bashku me autorizimin për kontrollim dhe sekuestrim dhe urdhrin e transferimit, t'ia përcjellë Administratores që në bashkëpunim me ZPS-në t'ua transmetojë autoriteteve përkatëse për zbatim.³⁰

²⁶ Rregullat 31(1)(b), 37(1).

²⁷ Rregulla 31(1)(c).

²⁸ *Shih* para.3 më lart.

²⁹ Ligji i Belgjikës për Bashkëpunim, nenet 86-87.

³⁰ Rregulla 55(1).

C. KËRKESË PËR MOSNXJERRJEN E PËRKOSSHME TË IDENTITETIT TË DËSHMITARËVE DHE VIKTIMAVE

18. Sikurse përshkruhet më lart, ekziston rrezik real, ndër të tjera, i ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve dhe viktimave, çka, në përputhje me rregullën 105, përbën rrethana të veçanta që përlligjin mosnxjerrjen e përkohshme të identitetit të dëshmitarëve dhe viktimave të përfshira në këtë proces, deri sa të urdhërohen masat e duhura mbrojtëse. Në përputhje me sa më lart, [REDAKTUAR] ZPS-ja i kërkon gjykatësit të procedurës paraprake:

- i. të urdhërojë që emri dhe mbiemri, si edhe informacioni identifikues i cilitdo dëshmitari ose viktime të përmendur në materialin mbështetës, të mos i bëhen të njohura publikut;
- ii. të autorizojë ZPS-në që të redaktojë emrat dhe informacionin identifikues të dëshmitarëve dhe viktimave të përmendur në materialin mbështetës, si edhe t'u caktojë atyre pseudonime të përkohshme, para se ato t'u bëhen të njohura të akuzuarit ose publikut; dhe
- iii. të urdhërojë që kjo mosnxjerrje e përkohshme të mbetet në fuqi deri në një urdhër të mëtejshëm të gjykatësit të procedurës paraprake me kërkesë të ZPS-së, apo pasi të ketë dëgjuar ZPS-në.

D. KËRKESË PËR MOSNXJERRJEN E AKTAKUZËS DHE INFORMACIONIT NË LIDHJE ME TË

19. Mosnxjerrja e Aktakuzës dhe informacionit që ka lidhje me të është e domosdoshme në këtë fazë për të garantuar integritetin e procesit dhe mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave. Sikurse përshkruhet më lart, ekziston rrezik real se z. SHALA, ndër të tjera, mund të arratiset, të ndërhyjë ndaj dëshmitarëve dhe viktimave, dhe të kryejë vepra penale të tjera, çka, në përputhje me rregullën 88(2), paraqesin arsye të vlefshme të cilat përlligjin mosnxjerrjen publike të përkohshme të Aktakuzës dhe dokumenteve e informacionit që kanë lidhje me të deri në një urdhër të mëtejshëm.

E. KLASIFIKIMI

20. Ky parashtrim së bashku me shtojcat dorëzohen si rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* në përputhje me rregullat 85(4) dhe 86(2).

F. MJETI LIGJOR QË KËRKOHET

21. Për arsyet e lartpërmendura, ZPS-ja i kërkon gjykatësit të procedurës paraprake:

- i. të konfirmojë Aktakuzën;
- ii. të lëshojë fletarrestim, autorizim për kontrollim dhe sekuestrim dhe urdhër për transferim, në përputhje me kushtet e kërkuara në pjesën B(4)-(5) më lart;
- iii. të urdhërojë mosnxjerrjen e përkohshme të identitetit të dëshmitarëve dhe viktimave, në përputhje me kushtet e kërkuara në pjesën C më lart; dhe
- iv. të urdhërojë mosnxjerrjen e përkohshme të Aktakuzës dhe të dokumenteve e informacionit lidhur me të, në përputhje me kushtet e kërkuara në pjesën D më lart.

Numri i fjalëve në origjinal: 2438

/nënshkrim/

Xhek Smith

Prokuror i Specializuar

E hënë, 26 prill 2021

Në Hagë, Holandë.